

Bashkëpunimi i detyruar dhe kujtesa historike: Një qasje reflektuese

Termi "Bashkepunor Sigurimi" është sa kompleks, por aq edhe delikat e i dhimbshëm.

Vete fjala "Bashkepunor" do të thote: "Te punosh me dike për të realizuar një projekt".

Ne kete rast, një krim të perbashket. "Persekutimin tone".

Deri në marrjen e dosjeve, nuk kisha djeni mbi veprimtarinë e kesaj kategorie. Sigurimi impenjoi në ndjekjen e familjes 23 Bashkepunore. Ishin të gjinive dhe moshave të ndryshme. Por një diçka i bashkonte; e ashtuquajtura "Biografi e keqe". Nuk pata problem për të identifikuar ata me kryesoret, ata që kishin lidhje direkt me ne. Pjesën tjetër e zbardhi AIDSSH. Në si familje me këta Bashkepunore, as kishim ndonjë aktivitet të perbashket armiqësor dhe as i kishim implikuar. Në qofte se ata ishin shantazhuar nga Sigurimi, nuk ishte pergjegjesia e jone. Nuk i kishim vene ne, në kete situacion.

Po perqendrohëm tek kategoria e bashkepunoreve "ish të burgosur politike".

Në 50 vjetorin e revoltës të Spaçit, mbas 41 vjetësh takova një shok të afert bashkevuajtes.

Në një nga takimet e mevonëshme me tregoi se, një pjesë e mirë e të burgosurve kishin punuar për Sigurimin. Fillimisht kjo mu duk e pa besueshme, por kur mora dosjet, pashe që kishte të drejte. Nga 8 ish bashkevuajtes që permenden në këto dokumenta, 4 ishin Bashkepunore.

Qellimi i Sigurimit ishte që shtresën e të perndjekurve ta perçante. Në kete mënyrë, një pjesë e shkatëronte moralisht dhe të tjerët i kalbte neper burgje. Me kushtet që Diktatura i krijoi kesaj kategorie, duhej shumë guxim dhe sakrifice për të ruajtur vlerat e larta njerzore.

Sigurimi u kishin premtuar anonimatën Bashkepunoreve. Por koha gjithmone ka treguar, se e verteta do të dalë në dritë.

Megjithatë, këta i detyruan.

Nuk dua të justifikoj, por i kuptoj. Jo të gjithë e patën forcën për të perballuar egërsinë e operativeve. Njerzit gjatë jetës mund edhe të gabojnë pa e kuptuar, por mund të bëjnë edhe fajë të rënda në kushte të caktuara. E rëndësishme është ajo, që kur të kuptojnë këto gabime ose fajë dhe kur të jepet mundësia (me kushtet e krijuara mbas 1990), duhet të pendohen dhe të kërkojnë falje personit dhe familjes që kanë demtuar.

Kane kaluar 35 vjet nga rënia e Diktatures. Askush prej tyre nuk bëri këte hap.

Arsyeja ?

Sepse kjo kërkon shumë kurajo. Këtyre personave kjo dhunti u ka munguar gjithmone.

Unë këta fatkeqë i meshirova. Nuk ja u nxora emrat në librat e mij.

Dhe ja pse:

a-Ata nuk vepruan me dëshirën e tyre. Zgjedhja që bëne për të pranuar këte rol ishte shumë e rëndë, jo vetëm për ne, por edhe për ata vete.

b-Nuk dëshiroj që dikush që nuk e ka jetuar atë periudhë, ose që nuk ka provuar mbi kurizën e tij shantazhet e Sigurimit, të gëjkojë dhe të denojë moralisht këta bashkepunore.

Megjithatë humba nga vitet me të bukura të jetës dhe mu shkatërrua e ardhmja, arrita në perfundim që nga ana e ime duhej: Ti falja.

Kjo bëri që të ndjehem më mirë.

Por të falesh, nuk do të thote të harrosh.

Fund